



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË
BERAT

**RAPORTI VJETOR I DREJTUESIT TË
PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË
SHKALLËS SË PARË BERAT MBI ECURINË
E PUNËS NË PROKURORI
PER VITIN 2023**



Berat, shkurt 2024

PËRMBAJTJA

Fjala hyrëse *Page*5

I. Drejtimit dhe përparësitë në luftën kundër kriminalitetit në vitin 2022.....6

- *Të dhëna për realizimin e objektivave prioritare të prokurorisë.....6*
- *Ritja e rolit aktiv të prokurorit në fillimin/regjistrimin e procedimeve kryesisht dhe kryerjen e hetimet proaktive.....6*
- *Informacion mbi zbatimin e Udhëzimeve të Përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm..6*
- *Informacion mbi zbatimin e Planit të Veprimit të Rezolutës së Kuvendit10*
- *Informacion mbi zbatimin e udhëzimeve të përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm në bazë të rekomandimeve prioritare të Keshillit të Ministrave..... 12*
- *Respektimi i të drejtave dhe interesave të ligjshme të shtetasve në procesin penal.....15*
- *Të miturit në konflikt me ligjin, viktima dhe dëshmitarë.....15*
- *Grupet vulnerabël, të pandehur dhe viktima.....16*
- *Bashkëpunimi ndërinstytucional dhe zbatimi i akteve/marrëveshjeve me Prokurorinë e Posaçme, me MFE e MB, Me KLSH, me ILDKPKI, etj.....16*
- *Bashkëpunimi ndërkombëtar.....17*
- *Të dhëna lidhur me trajnimet e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore.....17*

II. Analiza e treguesve të kriminalitetit dhe punës së prokurorisë.....18

- *Volumi i punës në hetim.....18*
- *Çështje të përfaqësuara në gjykatë.....19*
- *Treguesit kryesorë të punës së prokurorisë..... 19*
- *Të dhëna në lidhje me njoftimet për veprat penale.....20*
- *Të dhëna në lidhje me masat e sigurimit personal..... 20*
- *Të dhëna në lidhje me masat e sigurimit pasuror.....21*
- *Treguesit e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë.....21*
- *Kriminaliteti sipas shtrirjes territoriale.....21*
- *Kriminaliteti sipas përhapjes së veprave penale dhe tendencave të tyre.....21*
- *Kriminaliteti sipas strukturës së Kodit Penal (krime-kundërvajtje).....22*

III. Treguesit statistikorë 2 vjeçarë të veprave penale sipas strukturës së Kodit Penal.....	22
➤ <i>Në vitin 2021.....</i>	22
➤ <i>Në vitin 2022.....</i>	22
IV. Analiza e treguesve të efektivitetit të punës së prokurorisë.....	23
➤ <i>Treguesi i efektivitetit në hetim, dhe raporti i çështjeve të dërguar me kërkesë për gjykim, pushuara, pezulluara.....</i>	23
➤ <i>Treguesi i efektivitetit në gjykimin dhe dënimin e të pandehurve.....</i>	23
➤ <i>Të dhëna për gjykimet e posaçme.....</i>	23
➤ <i>Të dhëna mbi llojet dhe masat e dënimeve.....</i>	24
➤ <i>Të dhëna sociale dhe demografike për të pandehuri.....</i>	24
➤ <i>Të dhëna për të pandehurit e mitur.....</i>	24
➤ <i>Të dhëna për pasojat e veprave penale.....</i>	24
V. Të dhëna lidhur me marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja.....	25
➤ <i>Ekstradime, Letërporosi, Transferime procedimesh, Transferime te dënuarish, Shpalljet/Heqjet nga kërkimi ndërkombëtar.....</i>	25
VI. Të dhëna për ngarkesën e punës për çdo prokuror dhe oficer të policisë gjyqësore.....	25
➤ <i>Dritan Gripshi.....</i>	25
➤ <i>Albjona Papajani.....</i>	25
➤ <i>Eni Çulli.....</i>	25
➤ <i>Aida Yzeiraj.....</i>	25
➤ <i>Denisa Perdjaj.....</i>	25
➤ <i>Malvina Pëllumbi.....</i>	25
➤ <i>Ledion Tema.....</i>	25
➤ <i>Elidon Hysenaj.....</i>	25
➤ <i>Adnan Hoxha.....</i>	25
➤ <i>Erind Cela.....</i>	26
➤ <i>Gertmond Koroveshi.....</i>	26

➤ <i>Marcela Lala</i>	26
➤ <i>Afrim Cela</i>	26
➤ <i>Gentian Zhuzhuni</i>	26
➤ <i>Amarildo Nuhu</i>	26
➤ <i>Gestian Aliaj</i>	26
➤ <i>Arbnor Shehu</i>	26
➤ <i>Hasan Asllani</i>	26
VII. Informacion mbi administrimin e Prokurorisë	26
VIII. Informacion për marrëdhëniet me publikun dhe mediat	27
IX. Drejtimet dhe përparësitë në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023. Rekomandime	27
- <i>Tabelat e treguesve statistikorë bashkëlidhur raportit (vitet 2022, 2023)</i>	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË
BERAT**

**RAPORTI VJETOR I DREJTUESIT TË
PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË BERAT MBI
ECURINË E PUNËS NË PROKURORI
PER VITIN 2023**

DREJTUAR

**PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM
Z. Olsian ÇELA**

TIRANË

I nderuar Z. Prokuror i Përgjithshëm!

Në këtë raport synojmë të prezantojmë të dhënat dhe treguesit e ecurisë së veprimtarisë së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat për vitin 2023.

Ky raport përmban të dhëna që i referohen veprimtarisë së Prokurorisë në fazën e hetimit paraprak, në fazën e gjyimit, në fazën e ekzekutimit të vendimeve penale, të bashkëpunimit ndërkombëtar si edhe zbatimit të detyrimeve të tjera ligjore të normuara në ligjin procedural penal, në ligje të tjera apo akte nënligjore.

Metodologjia e këtij raporti, në përputhje edhe me raportet e viteve paraardhëse, konsiston në mbledhjen e të dhënave statistikore të punës së prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore, në sintezën e këtij informacioni dhe analizën e aspekteve të veçanta në veprimtarinë dhe administrimin e Prokurorisë. Raporti është i organizuar i tillë që të jetë në përputhje me standardet e përcaktuara në urdhrin nr. 330, datë 29.12.2016 të Prokurorit të Përgjithshëm *“Për përmbajtjen e raportit vjetor të Drejtuesit të Prokurorisë”*.

I. Drejtimit dhe përparësitë në luftën kundër kriminalitetit në vitin 2023

➤ Të dhëna për realizimin e objektivave prioritare të prokurorisë

Nga ana e prokurorëve të Prokurorisë Berat, në zbatim të Kushtetutës, udhëzimeve të përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm, kërkesave të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë, rekomandimet të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023 i është dhënë përparësi procedimeve penale, në fushën e krimit ekonomik dhe korrupsionit, abuzimi me detyrën nga nënpunësit shtetëror, në fushën e veprave penale kundër jetës së personit dhe moralit, zbatimit të kodit penal për të mitur etj. Intensifikimi i përpjekjeve nga prokurorët për të berë të mundur rritjen e treguesve të zbulueshmerise së veprave penale me rrezikshmëri të lartë shoqërore dhe marrjen në përgjegjësi penale të subjekteve përkatëse, si pastrimin e produkteve të veprës penale, vjedhjet etj, të cilat janë më të ndjeshme për shoqerine tonë.

Rritja e funksionit drejtues dhe kontrollues të prokurorit ndaj policisë gjyqësore, në seksionin dhe shërbimet e policisë gjyqësore.

Përmirësimi i organizimit, drejtimit dhe kontrollit të punës brenda organit, me qëllim për t'iu përgjigjur më mirë kërkesave për rritjen e cilësisë së punës.

Respektimi nga prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore i detyrimeve të ligjit procedural penal, urdhërave dhe udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm dhe atyre të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Rritja e profesionalizimit të prokurorëve në hetimin paraprak, në marrjen e vendimeve përfundimtare, në paraqitjen e kërkesave para gjyqtarit të seancës paraprake dhe në mbrojtjen e akuzës në gjykim si dhe ruajtjen e etikës dhe disiplinës në punë.

➤ Ritja e rolit aktiv të prokurorit në fillimin/regjistrimin e procedimeve kryesisht dhe kryerjen e hetimit proaktive

Për sa i përket procedimeve të filluara kryesisht nga prokurorët për gjatë vitit 2023 ka patur një procedim të filluar kryesisht. Nga ana e prokurorëve të Prokurorisë Berat, në varësi të natyrës së veprës penale, janë zhvilluar hetime proaktive, disa prej të cilave kanë rezultuar të suksesshme. Kryesisht, janë zhvilluar hetime proaktive për hetimin e veprave penale në fushën e korrupsionit, narkotikëve, pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, shfrytëzimi i prostitucionit, fallsifikimi i dokumentave etj, duke përdorur kryesisht metodat hetimore të përgjimit telefonik dhe vëzhgimit ambiental. Nga të dhënat statistikore rezulton se për vitin 2023 janë regjistruar 21 procedime për të cilët janë zhvilluar hetime proaktive.

➤ Informacion mbi zbatimin e Udhëzimeve të Përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm

Me qëllim zbatimin e udhëzimeve të përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm, nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë Berat janë hartuar, përveç masave konkrete të marra për zbatimin e tyre, si mbledhja e prokurorëve dhe diskutimi tyre, udhëzimet dhe urdhrat e mëposhtëm:

- **URDHËR nr. 1, datë 05.01.2023 “Për krijimin e komisionit të prokurimit me vlera të vogla”**, i nxjerrë në bazë të VKM Nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 40 “Procedura e prokurimit me vlerë të vogël” pika 3.
- **URDHËR nr.2 datë 05.01.2023 “Për krijimin e grupit për menaxhimin strategjik”** bazuar në Ligjin Nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 27, pika 2.
 - **URDHËR nr. 3 Datë 05.01.2023 “Për ngritjen e komisionit të kolaudimit dhe marrjes në dorëzim”** në mbështetje në Ligjin Nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik” I ndryshuar, Kreu IX, neni 77.
- **URDHËR nr.4 datë 05.01.2023“Për organizimin dhe ndarjen e detyrave në degën e financës”** në zbatim të Udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 të Ministrisë së Financave “Për menaxhimin e aktivëve në njësitë e sektorit publik”, të ndryshuar.
- **URDHËR nr. 5, datë 03.02.2023 “Miratimin r rregullores tip në Prokurorinë Berat dhe për gjurmët standarte të audiit”** bazuar në Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, në Ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30 datë 27.12.2021 të ndryshuar.
- **URDHËR nr. 6, datë 06.02.2023 “Për krijimin e Seksionit në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat”** në mbështetje të nenit 148 e vijues të “Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë” si dhe të neneve 21 dhe 42 e vijues te Ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe Udhëzimit Nr. 03 datë 29.12.2016 të Prokurorit të Përgjithshëm “për shpërndarjen e çështjeve në Prokurori” me qëllim plotësimin e seksioneve dhe shpërndarjen e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore nëpër seksione”.
- **URDHËR nr. 7, datë 06.02.2023 “Për caktimin e Oficerit për të drejtën e aksesit në bazën e të dhënave të drejtorisë së përgjithshme te doganave”** në zbatim të nenit 108/a të Ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në

Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar) dhe në kuadër të memorandumit të bashkëpunimit të nënshkruar midis Prokurorisë së Përgjithshme dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, shkresës nr.169/4 datë 10.03.2023 të Drejtorisë së Kohordinimit Institucional.

- **URDHËR nr. 8, datë 18.04.2023 “Për ndritjen e grupit të punës për plotësimin e të dhënave për vlerësimin e prokurore Albjona Papajani”.**
- **URDHËR nr. 9, datë 04.05.2023 “Për organizimin dhe përforcimin e sistemit të gadishmërisë në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat”** në mbështetje të Ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” si dhe Udhëzimit nr. 3 datë 21.06.2019 të Prokurorit të Përgjithshëm “Mbi masat administrative dhe procedurale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm në periudhën para dhe pas zgjedhjeve”
- **URDHËR nr. 10, datë 05.05.2023 “Për ngritjen e komisionit të pranimit dhe vlerësimit të kandidatëve për pozicionet e punës së shërbimit civil”** bazuar ne Urdhërin nr. 54 datë 18.04.2023, të Prokurorit të Përgjithshëm “Për miratimin e strukturës organike të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, e cila ka ndryshuar ne vitin 2023”.
- **URDHËR nr. 11, datë 08.05.2023 “Për emërimin në detyrë të Z.Sokol Asllanaj kryetar dege buxhet financës”** bazuar ne Urdhërin nr. 54 datë 18.04.2023, të Prokurorit të Përgjithshëm “Për miratimin e strukturës organike të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat”
- **URDHËR nr. 12, datë 14.06.2023 “Për marrjen në punë të Z.Clirim Cufollari në pozicionin Ftues - zëvëndësues”** bazuar ne Urdhërin nr. 54 datë 18.04.2023, të Prokurorit të Përgjithshëm “Për miratimin e strukturës organike të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat”
- **URDHËR nr. 13, datë 19.06.2023 “Për emërimin në detyrë të Znj Eltiana Dervishi në pozicionin kryesekretare”** bazuar ne Urdhërin nr. 54 datë 18.04.2023, të Prokurorit të Përgjithshëm “Për miratimin e strukturës organike të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat”
- **URDHËR nr. 14, datë 20.06.2023 “Për emërimin në detyrë të Z. Ylli Malasi në pozicionin specialist - arkivist”** bazuar ne Urdhërin nr. 54 datë 18.04.2023, të

Prokurorit të Përgjithshëm “Për miratimin e strukturës organike të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat”

- **URDHËR nr. 15, datë 20.06.2023 “Për emërimin në detyrë të Znj Lindita Hysi në pozicion punojës shërbimi”** bazuar ne Urdhërin nr. 54 datë 18.04.2023, të Prokurorit të Përgjithshëm “Për miratimin e strukturës organike të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat”
- **URDHËR nr. 16, datë 28.06.2023 “Për emërimin në detyrë të Z Kirjako Kati në pozicionin specialist - It”** bazuar ne Urdhërin nr. 54 datë 18.04.2023, të Prokurorit të Përgjithshëm “Për miratimin e strukturës organike të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat”
- **URDHËR nr. 17, datë 04.07.2023 “Për emërimin në detyrë të Z. Dritan Doraci në pozicionin shofer”** bazuar ne Urdhërin nr. 54 datë 18.04.2023, të Prokurorit të Përgjithshëm “Për miratimin e strukturës organike të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat”
- **URDHËR nr. 18, datë 05.07.2023 “Për ngritjen e komisionit të pranimit dhe vlerësimit të kandidatëve për pozicionet e punës së shërbimit civil”** bazuar ne Urdhërin nr. 54 datë 18.04.2023, të Prokurorit të Përgjithshëm “Për miratimin e strukturës organike të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat”
- **URDHËR nr. 19, datë 10.07.2023 “Për emërimin në detyrë të Zv.Drejtuës të Prokurorisë”** Në mbështetje dhe zbatim të nenit 44 të Ligjit Nr. 97/2016, datë 06.10.2016 “për Organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë, si dhe Urdhërit nr. 101, datë 12.06.2019 të Prokurorit të Përgjithshëm “Për miratimin e rregullave për emërimin e zëvendës drejtuesit të Prokurorisë në prokuroritë me Juridiksion të Pergjithshëm”.
- **URDHËR nr. 20, datë 20.07.2023 “Për disa ndryshime dhe shtesa në urdhërin e datës 06.02.2023, “Për krijimin e Seksionit në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat”** në mbështetje të nenit 148 e vijues të “Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë” si dhe të neneve 21 dhe 42 e vijues te Ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe Udhëzimit Nr. 03 datë 29.12.2016 të Prokurorit të

Përgjithshëm “për shpërndarjen e çështjeve në Prokurori” me qëllim plotësimin e seksioneve dhe shpërndarjen e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore nëpër seksione”.

- **URDHËR nr. 21, datë 16.10.2023 “Për shkëputjen e marrëdhënieve të punë të Z.Clirim Cufollari”** bazuar ne Urdhërin nr. 54 datë 18.04.2023, të Prokurorit të Përgjithshëm “Për miratimin e strukturës organike të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat”
- **URDHËR nr. 22, datë 20.10.2023 “Për emërimin në detyrë të Znj. Hyrije Zeqaj në pozicionin Sekretare Pranë Prokurorëve”** bazuar ne Urdhërin nr. 54 datë 18.04.2023, të Prokurorit të Përgjithshëm “Për miratimin e strukturës organike të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat”

➤ *Informacion mbi zbatimin e Rezolutës së Kuvendit dhe Planit të Veprimit në zbatim të saj*

- Lidhur me të dhënat që evidentojnë rritjen e rolit aktiv të prokurorëve në ushtrinë kontroll efektiv në punën e oficerëve të Policisë Gjyqësore, janë organizuar mbledhje të shumta nga Drejtuesi i Prokurorisë por edhe me kërkesë të prokurorëve në lidhje me kontrollin e punës të oficerëve të policisë gjyqësore dhe nuk janë konstatuar problematika. Gjithashtu është tërhequr vëmendja nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë për oficerat e policisë gjyqësore, në lidhje me zbatimin e orarit të punës, etikës, zbatimin me korektesë sipas ligjit për pyetjen e personave në hetim, të pandehurve, viktimave të veprës penale etj. Gjatë këtij viti nuk janë evidentuar raste që duhen proceduar në rrugë disiplinore nga ana e oficerëve të policisë gjyqësore.
- Lidhur me masat për veprat penale të dhunës ndaj grave e dhunës në familje si dhe për veprat penale të kryera nga të miturit në konflikt me ligjin. Jan regjistruar rreth 47 procedime për veprën penale “Dhuna në familje”, janë ndjekur politika shtrenguese për këto vepra si te masat e sigurimit ashtu edhe në masën e dënimit për çështjet e dërguara në gjykatë. Jan regjistruar rreth 38 procedime për veprat penale të kryera nga të miturit në konflikt me ligjin, si dhe janë zbatuar me korektësi rregullat e udhëzimeve për këto vepra penale. Në përfundim për shumicën e rasteve janë aplikuar masat e shmangies nga ndjekja penale të të miturit në konflikt me ligjin. Për sa i përket viktimave për këto grup vepra penale, janë zbatuar të gjitha rregullat dhe nuk janë konstatuar problematika, si dhe është thërritur sa her është parë e nevojshme Koordinatorja për asistencën ndaj subjekteve me status të posacëm, e cila ka lozur një rol të rëndësishëm. Gjithashtu janë marë masa për forcimin e kapaciteteve për

hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve të kryera kundër fëmijëve në internet, edhe pse kemi një numër shumë të vogël për sa i përket këtyre veprave dhe për natyrën dhe fleksibilitetin që mbartin në vetvete këto vepra, nga ana e prokurorëve janë hetuar me korektesë dhe përparësi, si dhe nuk janë konstatuar problematika.

- Lidhur me hetimet financiare për gjatë vitit 2023 nuk ka patur të tilla. Prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore kanë marrë pjesë në trajnime sa herë u është bërë ftesë kur ka patur trajnime me tema mbi hetimet financiare. Për sa i përket hetimeve për veprën penale “Falsifikimit të monedhave” të parashikuar nga neni 183 i Kodit Penal, në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, për gjatë vitit 2023 nuk ka patur procedime penale të regjistruara për këtë veprë penale.
- Lidhur me informacionin e bazuar në analizë dhe tregues statistikorë mbi masat organizative në zbatim të hartës së re gjyqësore, si dhe nevojat e dala dhe planet e rekomanduara për adresimin e çështjeve të pazgjidhura, ju bëjmë me dije se Prokurorina Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat nuk është prekur nga zbatimi i hartës së re gjyqësore.
- Lidhur me shkëmbim informacioni me institucionet ligjzbatuese për rastet e trafikimit të armëve të zjarrit, ju bëjmë me dije se në drejtim të goditjes për këtë veprë penale është bërë një punë e shkëlqyer nga ana e prokurorisë në bashkëpunim edhe me agjensitë e tjera ligjzbatuese, ku vlen të përmendim se kanë rezultuar me sukses procedimet penale të regjistruara për këtë veprë penale. Duke dekloruar me prova dhe fakte si dhe ashpërsimin e masës të dënimit për autorët e këtyre veprave penale.
- Lidhur rritjen e kapacitetit institucionale dhe profesionale si dhe bashkëpunimi ndërinsitucional nëpërmjet përdorimit të rrjetit të pikave të kontaktit, të ngritur në zbatim të Konventës së KiE-së për krimin kibernetik për të rritur efektivitetin në luftën kundër krimit kibernetik dhe mashtrimin në internet, ju bëjmë me dije se, për gjatë vitit 2023 në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, nuk ka patur raste me bashkëpunim nëpërmjet pikave të kontaktit, pasi edhe veprat penale që lidhen me krimet kibernetike në këtë prokurori janë në numër shumë të vogël.
- Lidhur me forcimin e bashkëpunimit dhe koordinimit me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, ju informojmë se është mbajtur me konsideratë bashkëpunimi me këtë institucion. I janë dërguar informacione në kohë reale sa herë që ky institucion ka paraqitur kërkesa në prokurori në lidhje me ushtrimin e funksionit të prokurorëve, si dhe kur janë konstatuar shkelje individuale nga ana e magistratëve i është vënë në dispozicion i gjithë dekloracioni i kërkuar si dhe relacion shpjegues sipas rastit.

➤ Informacion mbi zbatimin e udhëzimeve të përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm në bazë të rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave

Në kuadër të rekomandimeve të Këshillit të Ministrave vlerësoj se jemi përpjekur për përmbushjen e prioriteteve të parashikuara në rekomandimet e Këshillit të Ministrave.

- Lidhur me masat administrative për nxjerrjen e një udhëzimi të përgjithshëm dhe për hartimin e miratimin e një plani veprimi për zbatimin e rekomandimeve prioritare të udhëzimit të përgjithshëm nr.2/2023, është organizuar mbledhja e prokurorëve për tërheqjen e mendimeve të prokurorëve për masat eventuale dhe mënyrën e zbatimit të tyre, por ky proces nuk është përfunduar dhe ende nuk është konkluduar për nxjerrjen e një udhëzimi dhe plani veprimi.
- Lidhur me masat e marra në drejtim të riorganizimit të brendshëm në zbatim të hartës së re gjyqësore, theksojmë se Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat nuk është prekur nga kjo hartë gjyqësore. Koordinimi dhe forcimi i kapaciteteve institucionale dhe profesionale, janë njohur prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore me rekomandimet përkatëse të Këshillit të Ministrave, duke u kërkuar zbatimin me efektshmëri të rekomandimeve. Së fundmi, janë marrë masat administrative dhe procedurale në Prokurorinë e Beratit për rritjen e efektivitetit në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe garantimin e pavarësisë së prokurorëve dhe përgjegjshmërisë së tyre. Në kuadër të udhëzimit janë respektuar me rigorizitet të drejtaj e njeriut. Gjithashtu janë mbajtur trajnime dhe mbledhje të shumta për sa i përket forcimit të bashkëpunimit ndërinstitucional.
- Lidhur me masat procedurale të marra në fazën e hetimeve, ushtrimin të ndjekjes penale dhe përfaqësimit në gjyq të çështjeve në drejtimet e trajtuara nga rekomandimet, nuk janë konstatuar problematika. Në lidhje me udhëzime jo të detyrueshme të nxjerra për çështje konkrete, për periudhën raportuese nuk ka pasur raste të tilla. Gjithashtu nuk ka patur raste të koordinimit të veprimtarisë me prokurori të tjera. Ndarja e çështjeve nëpërmjet sistemit CAMS bëhet për të gjitha materialet referuese apo kallëzimet e ardhura në prokurori, jashtë këtij shorti ndahen materialet referuese me personat e arrestuar në flagrancë, ndaluar apo procedime proactive, për të cilat caktohet prokurori I gatshëm sipas grafikut të gadishmërisë. Gjithashtu jashtë këtij shorti ndahen dhe çështjet me grupveprat penale të parashikuara nga nenet 287, 287/b, 180, 181, 181/a, 164, 170/ç, 171, 179/ç, 230/a dhe 230/b të K.Penal, të cilat bazuar në urdhërin e drejtuesit të prokurorisë I kalojnë një prokurori të caktuar. Gjithashtu gjatë këtij viti është krijuar seksioni për çështje me të mitur I përbërë nga tre prokurorë, dhe çështjet me persona të mitur qoftë si persona në hetim apo viktimat të veprës penale hidhen në llotari të ky seksion I caktuar. Hedhja e të dhënave dhe administrimi I regjistrave mbahet në mënyrë korekte dhe nuk janë konstatuar problematika. Në lidhje me pasqyrimin në regjistrat përkatës

ecurinë e procedimit dhe dërgimin në afat të të dhënave statistikore në Prokurorinë e Përgjithshme, dhe jo vetëm, që lidhen me drejtimit prioritare të rekomanduara dhe progresin e integritetit të vendit nga ana e zyrës së regjistrimit janë zbatuar me korektesë dhe nuk janë konstatuar problematika në këtë drejtim. Në lidhje me masat e marra për monitorimin dhe përditësimin e vazhdueshëm dhe plotësimin e të dhënave në sistemet elektronike PRESTO dhe SVHOPGJP, ju bëjmë me dije se, sistemi PRESTO administrohet nga drejtuesi I prokurorisë, dhe janë edhur të dhenat në lidhje me procedimet penale për pastrimin e parave, si dhe bëhen ndryshime në sistem sa herë që këto procedime penale ndryshojnë statusin e tyre. Për sistemin elektronik SVHOPGJP, përdoret nga të gjithë O.P.Gj-të e prokurorisë dhe hidhen të dhëna në mënyrë periodike ditore për çdo veprim hetimor nga ana e O.P.Gj-ve të prokurorisë.

- Lidhur me masat e marra nga Drejtuesi i Prokurorisë për procedime të filluara kryesisht apo hetime proactive mbi inicimin e drejtuesit të prokurorisë për grupveprat penale prioritare të rekomanduara për periudhën raportuese nuk ka patur të tilla. Nuk janë konstatuar problematika në lidhje me verifikimin e ecurisë të çështjeve për veprat penale prioritare të rekomanduara. Janë mbajtur 7 mbledhje me prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore dhe administratën në lidhje me veprat penale prioritare të rekomanduara, si dhe me tematika për zbatimin e orarit të punës, etikën në punë, shpërndarjen e ngarkesës të punës, disiplina në punë, mbledhje me oficerët e policisë gjyqësore të Drejtorisë Vendore të Policisë Berat dhe të Komisariateve në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional, etj. Është nxjer Urdhëri nr.05 datë 03.02.2023 “Miratimin e rregullores tip në Prokurorinë Berat dhe për gjurmet standartet të auditit”. Është nxjer Urdhëri nr.06 datë 06.02.2023 “Për Krijimin e Seksionit për veprat penale të kryera nga të Miturit dhe ndaj tyre, veprat penale kundër moralit dhe marrëdhënieve familjare, qarkullimit dhe kundër drejtësisë”, si dhe caktimin e O.P.Gj-ve për këtë seksion. Është nxjer Urdhëri nr.07 datë 07.03.2023 “Për caktimin e Oficerit për të drejtën e aksesit në bazën e të dhënave të drejtorisë së përgjithshme të doganave”. Është nxjer Urdhëri nr.08 datë 18.04.2023 “Për ngritjen e grupit të punës për plotësimin e të dhënave për vlerësimin e prokurores Albjona Papajani”. Është nxjer Urdhëri nr.09 datë 04.05.2023 “Për organizimin dhe përforcimin e sistemit të gadishmërisë”. Është nxjer Urdhëri nr.10 datë 05.05.2023 “Për ngritjen e komisionit të pranimit dhe vlerësimit të kandidatëve për pozicionet e punës së shërbimit civil”. Është nxjer Urdhëri nr.19 datë 10.07.2023 “Për emërimin në detyrë të zëvendës drejtuesit të prokurorisë”. Treguesit nga monitorimi I të dhënave në sistemin elektronik SVHOPGJP, për secilin nga oficeret e policisë gjyqësore është, O.P.Gj Gertmond Goroveshi 243 veprime, Erind Cela 304 veprime, Afrim Cela 879 veprime, Marcela Lala 473 veprime, Gentian Zhuzhuni 560 veprime, Amarlido Nuhu 320 veprime. Mbështetja e dhënë prokurorëve në ushtrimin e funksioneve dhe nxjerja e vendimeve për ngritjen e gupit hetimor në ndihmë të prokurorit për çështje komplekse. Ngelet për përmisim për shkak të mungesës të ambienteve përshtatja e një ambienti në zbatim të Kodit të Drejtësisë për të

Mitur dhe personave me aftesi fizike, për pritjen e publikut është përshtatur një ambjent I posaçëm në hyrjen e brëndëshme të Prokurorisë, ku punojësja e re sipas strukturës angazhohet me pritjen e publikut dhe sqarimin e tyre sipas kërkesave që ata kanë. Përgjatë vitit 2023 janë organizuar takime të rëndësishme me institucione të tjera ligjzbatuese në kuadër të luftës kundër veprave prioritare të rekomanduara. Kanë marrë pjesë në tranjimet e përbashkëta me agjencitë e zbatimit të ligjit prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore në fushat e rekomanduara dhe janë zbatuar me përparësi veçanërisht ato me fokus në luftën kundër korrupsionit, krimet e rënda dhe trafikimet e paligjshme, veprat me bazë gjinore, seksuale dhe me përfshirjen e të miturve, si dhe me focus bazushmeria në ligj e hetimeve dhe vlefshmëria e provave në hetimet financiare, evazionit fiscal dhe krimeve kibernetike.

- Lidhur me masat procedurale të marra nga prokurorët në përputhje me rekomandimet prioritare rezulton se për vitin 2023 ka patur 1 procedim/hetim të filluar kryesisht nga prokurorët, ndërsa në vitin 2022 nuk ka patur procedime të filluara kryesisht nga prokurorët. Gjatë vitit 2023 janë regjistruar 21 procedime proaktive ku janë përdorur metoda speciale të hetimit dhe kryesisht kanë rezultuar të suksesshme për mbledhjen e provave dhe ngritjen e akuzës në gjykatë. Ndërsa në vitin 2022 numri i hetime proaktive ka qënë 22. Lidhur me hetime financiare për gjatë vitit 2023 nuk ka patur të tilla, ndërsa numëri i hetimeve pasurore për vitin 2023 është 12. Në lidhje me marrëveshjet e bashkëpunimit në zbatim të nenit 37/a të Kodit të Procedurës Penale në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat nuk ka patur marrëveshje të tilla.. Institucione ligjzbatuese ku prokurori ka akses në përdorim janë Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, për nxjerjen e çertifikatave elektronike të gjëdjes gjyqësore, Drejtora e Përgjithshme e Doganave, përdorimi i e-albania, etj... Në lidhje me analizat e përbashkëta me oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve dhe të shërbimeve policore në strukturat hetimore përkatëse për gjatë kohës së raportimit nuk ka patur të tilla. Nuk janë konstatuar paregullësi për sa i përket ruajtjes të sekretit hetimor apo publikimit të akteve. Janë bërë mbledhje me drejtuesin e prokurorisë dhe prokurorët për zbatimin nga ana e prokurorëve të udhëzimeve të përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm sipas fushave prioritare të rekomanduara dhe nuk janë konstatuar problematika. Është mbajtur në monitorim të vazhdueshëm nga ana e prokurorëve për sa i përket zbatimit me efektivitet për të drejtat procedurale për të pandehurit, personave nën hetim, të dyshuarve apo dhe viktimave, për garantimin e procesit të regullt ligjor dhe nuk janë konstatuar problematika. Përgjatë hetimeve janë respektuar të drejtat e të pandehurve apo personave nën hetim, veçanërisht është mbajtur në konsideratë e drejta e mbrojtjes. Pretendime të pakta që mund të jenë ngritur për procedura të caktuara kanë qënë kryesisht të pabazuara në kodin e procedurës penale, e për rrjedhojë edhe nga gjykata nuk janë konstatuar shkelje të natyrës procedurale në atë nivel që të konsiderohen cenim i ndonjë të drejte të të pandehurit apo personit nën hetim. Në këtë drejtim, duhet përmendur se është ndjekur një politikë penale më e kujdesshme, veçanërisht në masat e sigurimit dhe dënimet përfundimtare. Janë bërë përpjekje për kufizimin e kërkesave për

caktimin e masave të sigurimit me arrest në burg dhe dënimet përfundimtare me burgim, duke i aplikuar këto masa në rastet e veprave penale me rrezikshmëri të theksuar shoqërore, si vepra penale të kultivimi I narkotikëve, dhunës në familje, dhuna gjinore, krimet seksuale dhe veprat penale të tjera të rekomanduara. Janë zbatuar masat alternative të shmangies ndaj të miturve në konflikt me ligjin për të gjithë të miturit që përfitojnë nga kjo masë shmangie. Në rastet për zbutjen e dënimit apo aplikimin e dënimeve alternative në rastet e veprave penale ose autorëve me rrezikshmëri të ulët shoqërore, personave vunerabël ose personave me probleme serioze shëndetësore janë mbajtur parasysh zbatimet e neneve 59 dhe 63 të K.P.Penal. Prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore kanë marr pjesë në trajnimë sa herë u është bërë ftesë për trajnime duke përfshirë edhe në temat për zbatimin e dispozitave të reja të Kodit Penal etj. Si dhe janë mbajtur trajnime të përbashkëta me oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve dhe të strukturave hetimore të shërbimeve, me focus në fushat dhe drejtimit prioritare të rekomanduara sipas udhëzimeve.

➤ *Respektimi i të drejtave dhe interesave të ligjshme të shtetasve në procesin penal*

Në kuadër të garantimit dhe respektimit të të drejtave të njeriut, vlerësoj se prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore të seksionit të Prokurorisë kanë mbajtur vazhdimisht në konsideratë gjatë punës së tyre respektimin e të drejtave të njeriut.

Përpos përparësive në luftën ndaj kriminalitetit, siç janë hetimi i disa veprave penale, për të cilat ka një shqetësim në shkallë të gjerë në mbarë opinionin publik, por edhe në atë social, kulturor, juridik, ekonomik etj, si *shpërdorimi i detyrës, korrupsioni, falsifikimi* etj, nga prokurorët është mbajtur në konsideratë respektimi i të drejtave themelore dhe parimeve kushtetuese si e drejta për informim, parimi i prezumimit të pafajësisë, parimi i barazisë para ligjit, mosdiskriminimi, e drejta për të respektuar jetën private dhe familjare, e drejta e konfidencialitetit të të dhënave personale që mund të përftohen gjatë procesit hetimor, mosmarrja e të dhënave me anë të dhunës, trajtimi i diferencuar i grave dhe të miturve, e drejta për t'u njohur me akuzën, me shkaqet e arrestimit apo ndalimit dhe konfirmimi në gjykatë i ligjshmërisë së kryerjes së këtyre veprimeve etj. Nga ana e drejtuesit të Prokurorisë dhe prokurorëve janë bërë përpjekje që të njëjtat parime të udhëheqin punën edhe të oficerëve të policisë gjyqësore të drejtorisë vendore të policisë dhe komisariateve.

➤ *Të miturit në konflikt me ligjin, viktimat dhe dëshmitarët*

Përgjatë vitit 2023, vlerësoj se Prokurorët kanë mbajtur në konsideratë të drejtat e të miturit në konflikt me ligjin si në rastin kur mund të kenë pasur cilësinë e të pandehurit/personit nën hetim, ashtu edhe nëse kanë qenë viktimat apo dëshmitarët të ndonjë vepre penale. Duhet theksuar se për këtë vit ka përmirësime të ndjeshme në këtë drejtim si pasojë edhe krijimit të seksionit për çështjet me të mitur. Ky seksion është përbërë nga tre prokuror dhe konkretisht, Drejtuesi seksioni prokurori Eni Çulli dhe dy prokurorët e tjerë Malvina Pëllumbi dhe Denisa Perdja. Për këtë vit, nga statistikat rezulton se të pandehurit e mitur janë kryesisht të përfshirë në veprat penale të "Drejtimi i mjetit

në mënyrë të pargullt”. Në çështjet penale, ku autori i mitur është zbuluar pasi ka ndodhur vepra penale, prokurorët kanë orientuar oficerët e policisë gjyqësore, që të procedohet në përputhje me “Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur”, duke u treguar të kujdesshëm me masat kufizuese të lirisë, që ato të jenë në përputhje me direktivat që përmban ky kod, që në veprime procedurale me të miturin, të garantohet asistencë detyrimisht e mbrojtësit, psikologut, familjarit, si edhe në marrjen e masave për njoftimin e organeve vendore që kanë si kompetencë të tyre trajtimin social të të miturve. Sa i përket të miturve viktime apo dëshmitarë, sërish nga ana e prokurorëve është orientuar që veprimet procedurale me këta shtetas të kryhen në praninë e psikologut dhe nëse ka qenë rasti, edhe të prindërve.

➤ Grupet vulnerabël të pandehur dhe viktime

Përgjatë vitit 2023, Prokurorët kanë mbajtur në konsideratë të drejtat e këtyre grupeve të veçanta shoqërore. Me rëndësi dhe vëmendje janë trajtuar rastet e grave, veçanërisht ato që janë viktime të një vepre penale.

Përpos këtyre kategorive, nga ana e prokurorëve dhe e oficerëve të policisë gjyqësore një vëmendje e veçantë u është kushtuar të moshuarve, personave me demtime fizike (të pandehur ose viktime), si edhe viktimave të dhunës në familje ose dhunës seksuale. Kjo vëmendje ka konsistuar në kryerjen e veprimeve hetimore të shpejta, të gjithanshme dhe dinamike, si edhe mbajtjen në konsideratë të një politike të drejtë dënimesh në rastet e këtyre të pandehurve.

➤ Bashkëpunimi ndërinstitucional, analiza të zhvilluara dhe zbatimimi i akteve/marrëveshjeve me Prokurorinë e Posaçme, me MFE e MB, Me KLSH, me ILDKPKI, etj

Gjatë vitit 2023 janë mbajtur raporte korrekte dhe është bërë përpjekje maksimale për zbatimin e akteve dhe marrëveshjeve me institucione të tjera, në zbatim të ligjit procedural, ligjeve që rregullojnë veprimtarinë e organeve përkatëse dhe atij organik për Prokurorinë Shqiptare.

Gjatë gjithë vitit 2023, ka patur një marrëdhënie shumë të ngushtë bashkëpunimi Prokurorinë e Posaçme, duke përmëndur këtu transferimin e disa procedimeve, shkëmbimine informacionit, dërgimin e të dhënave të kërkuara etj..., Edhe me K.L.SH është mbajtur një bashkëpunim korekt, edhe pse nuk ka patur raste të kallëzimeve penale nga ky institucion për gjatë këtij viti. Ndërsa me institucione të tjera të pavarura si MFE e MB, ILDKPKI, Avokati i Popullit etj, është mbajtur një bashkëpunim i regullt në lidhje me korespondencën dhe shkëmbimin e informacionit sa herë është kërkuar. Konstatohet se për gjatë vitit 2022 nuk ka patur kallëzime penale nga këto institucione.

➤ Bashkëpunimi ndërkombëtar

Me qëllim bashkëpunimin e efektshëm në ushtrimin e ndjekjes penale apo marrjen e masave dhe kryerjen e veprimeve të ndryshme procedurale, lidhur me veprat penale që kanë kryer shtetasit

shqiptarë jashtë shtetit, apo shtetasit e huaj në qarkun e Beratit, nga ana e Prokurorisë Berat janë mbajtur kontakte të vazhdueshme me Prokurorinë e Përgjithshme dhe Ministrinë e Drejtësisë, si dy organet kompetente që mundësojnë ndërmjetësimin e bashkëpunimit me autoritetet e huaja.

Ndërsa në lidhje me bashkëpunimin nëpërmjet prokurorit ndërlidhës shqiptar ne EUROJUST, në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat, për gjatë vitit 2023 nuk ka patur raste të tilla.

➤ Të dhëna lidhur me trajnimet e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore

Për gjatë vitit 2023 prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore kanë marë pjesë në trajnime sa herë që u është bërë ftesë për trajnime. Trajnimet që janë ndjekur kanë qenë ato të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës, Prokuroria e Përgjithshme dhe partnerët si Euralius, Opdat etj. Prokurorët dhe Oficerët e Policisë Gjyqësore të Prokurorisë Berat për gjatë vitit 2023 kanë marë pjesë për trajnimet me temat si “Shfrytëzimi seksual online i të miturve”. “Cilesia e akteve procedurale të mbajtura nga Oficerët e Policisë Gjyqësore”. “Metodat dhe teknikat e hetimit të krimit kibernetik”. “Hetimi, ndjekja penale dhe gjykimi i veprave të pastrimit të parave, përfshirë çështjet e lidhura me korrupsionin”. “Krimet Kompjuterike, metodika dhe teknikat e hetimit të krimit kibernetik. Administrimi i provave kompjuterike dhe sekuestrimi i pajisjeve që mbartin prova dhe të dhëna që lidhen me teknologjinë në këtë fushë.” “Procesi i hetimit nga vendgjarja në sallën e gjyqit”. “Kontrolli i vendeve dhe banesës, rëndësia e tyre për suksesin e procedimit penal. Lidhja e këtij mjeti të kërkimit të provës me llojin e veprës penale për të cilën procedohet dhe detyrueshmëria e zbatimit të tij në rastet e veprave penale të veçanta. Standardi kushtetues dhe procedural i kontrollit të banesës, jurisprudenca e gjykatave shqiptare dhe GJEDNJ-së.” “Veprat penale në fushën e prokurimit publik. Trajtimi i rasteve dhe hetimi efektiv i veprave penale që lidhen me fushën e prokurimeve publike. Pabarazia në tendera si vepër penale, sipas nenit 258 të Kodit Penal.” “Cilësia e akteve procedurale të mbajtura nga OPGJ-ja gjatë hetimeve paraprake. Rëndësia e formës së tyre. Përfundimi i veprimeve hetimore, mënyra e përfundimit të hetimeve. Relacioni përfundimtar për përfundimin e hetimeve, përgatitur nga oficeri i policisë gjyqësore, vlera procedurale forma dhe përmbajtja e tij”. “Krimi kibernetik. Kuadri ligjor. Metodika dhe teknikat e hetimit, administrimi i provave kompjuterike dhe sekuestrimi i pajisjeve që mbartin prova dhe të dhëna që lidhen me teknologjinë në këtë fushë.

Aktet me natyrë raciste dhe ksenofobe të kryera nëpërmjet sistemeve kompjuterike.

Problematikat me natyrë ekstremiste fetare. Mohimi i genocidit dhe holokaustit.

Rastet e akteve me natyrë raciste drejtuar emigrantëve dhe azilkërkuesve.

Rrjetet sociale dhe grupet e marxhinalizuara (personat me probleme të shëndetit mendor ose me paaftësi të tjera fizike, përfshirja e të miturve, komuniteti LGBTQ, etj)

Provat elektronike për hetimin e krimit kibernetik. Gjuha dhe krimet e urrejtjes”. “Sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurive në kuadër të ligjit "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë". “Përgjimi, infiltrimi, blerja e kontrolluar etj, si mjete të veçanta të kërkimit të provës në mbështetje të hetimeve komplekse dhe proaktive. Praktika jonë gjyqësore dhe ajo e GJEDNJ-së. Njoftimi anonim i kryerjes së veprës penale, rëndësia dhe kompetenca e prokurorit pas marrjes së tij” “Paragjykimet dhe njëanshmëria e pavetëdijshme (konjitive) në gjykim: Paragjykimet dhe njëanshmëria e pavetëdijshme sipas studimeve neuro- psikologjike dhe epistimologjike, njohja dhe

kuptimi; ndikimi paragjykimëve të pavetëdijshme të magistratit në vendimmarrje dhe vlerësimin e provave”. “Urdhri Europian i ndalimit” dhe “arrestet ndërkombëtar” si instrumente të rëndësishme për përafrimin e legjislacionit vendas me atë të BE-së”. “Vlerësimi etiko-profesional i magistratëve. Sjellja e gjyqtarëve dhe prokurorëve në ushtrim të funksioneve të tyre zyrtare; sjellja e gjyqtarëve dhe prokurorëve jashtë ushtrimit të funksioneve të tyre zyrtare. Dallimi ndërmjet shkeljeve në kuadër të vlerësimit etiko-profesional nga shkeljet me karakter disiplinor. Etika gjyqësore.” Ekstradimi. Rëndësia e marrëveshjes ndërshtetërore për lejimin e ekstradimit jashtë të shtetasve shqiptarë. Autoriteti i ministrit të Drejtësisë për të vlerësuar përmbajtjen e kërkesës për ekstradim. Ne bis in idem. Njohja e vendimit penal të huaj dhe fillimi i hetimeve të brendshme për shkak të njoftimit të kërkesës për ekstradim, nenet 6; 7 dhe 7/a të Kodit Penal”. Etj....,

II. Analiza e treguesve të kriminalitetit dhe punës së prokurorisë


➤ Volumi i punës në hetim

Pranë kësaj Prokurorie, gjatë vitit **2023** janë **regjistruar** gjithsej të reja **768** (nga këto **19** ushtarake) proçedime penale. Në regjistrin përkatës të kësaj Prokurorie, gjatë vitit **2023**, janë regjistruar edhe **371** materiale për të cilat është vendosur mosfillimi i proçedimit penal, ose janë në fazë verifikimi. Gjithashtu për vitin **2023** janë regjistruar edhe **291** materiale në lidhje me Memorandumin e mirëkuptimit për zbatimin e nenit 59 të Kodit të Procedurës Penale midis Prokurorisë së Përgjithshme dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Nga këto të dhëna të përgjithshme, rezulton se gjatë vitit **2023** (duke përfshirë proçedimet dhe mosfillimet) në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Berat, janë **trajtuar gjithsej 1139** materiale hetimore të reja. Nga viti **2022**, janë **mbartur** gjithsej **1405** proçedime penale, me **153** persona të pandehur dhe **286** nën hetim, prej të cileve **70** të arrestuar. Në vitin **2023**, duke përfshirë tashmë edhe çështjet e mbartura, është ushtruar ndjekja penale në hetimin paraprak për **2544** materiale proçedurale penale.

✚ *Krahasuar me vitin 2022, këtë vit konstatohet një ulje e materialeve proçedurale penale me afërsisht 515 të tilla.*

- Grafiku për vitet 2023 dhe 2022





	Procedime	Mosfillime	Materiale total	Te mbartura	Ngarkesa efektive
Viti 2023	768	371	1139	1405	2544
Viti 2021	696	691	1387	1680	3067

➤ Çështje të përfaqësuara në gjykatë

Duke përfshirë edhe procedimet e mbartura në gjykim nga vitet e kaluara, gjatë periudhës njëvjeçare prokurorët janë paraqitur për të mbrojtur akuzën në gjykatë për **681** proçedime penale, me **778 të pandehur**, nga të cilët **199** janë gjykuar nën masën e sigurimit «**arrest në burg**». Ka përfunduar gjykimi për **370** proçedime penale, me **405** të pandehur, prej të cilëve **103** të arrestuar.

➤ Treguesit kryesorë të punës së prokurorisë

- Në vitin **2023**, janë **mosfilluar** gjithsej **371** materiale hetimore penale.
- Gjatë vitit 2023, janë **pushuar** gjithsej **281** proçedime penale, nga të cilat: **150** proçedime për **mungesë të faktit** penal, **10** proçedime për **mungesë të provës dhe 121** proçedime për shkaqe të tjera proçedurale.


Në procedimet penale të pushuara :

Eshtë **pushuar** ndjekja penale për **73** persona nën hetim, nga të cilët **0** kanë qënë të arrestuar.

- Gjatë vitit 2023, janë **pezulluar** gjithsej **224** proçedime penale, të gjitha këto për shkak se nuk është bërë e mundur të zbulohet autori i veprës penale.
- Gjatë vitit **2023**, janë **transferuar** gjithsej **7** proçedime penale.
- Në vitin 2023, janë **dërguar për gjykim** gjithsej **425 procedime** penale, me **459** persona **të pandehur**. Ndër të pandehurit, **86** prej tyre kanë qënë me masë sigurimi arrest në burg, kurse pjesa tjetër janë ndjekur me masa të ndryshme sigurimi.

✚ *Krahasuar me vitin 2022, në vitin 2023 janë përfunduar nga prokurorët rreth 102 çështje penale më pakë. Konkretisht, për vitin 2022 janë marrë 1410 vendimmarrje, ndërsa në vitin 2023 janë 1308 vendimmarrje.*

- Grafiku për vitet 2023 dhe 2022



	Vendimarrje		
Viti 2023	1308		
Viti 2022	1410		

Të dhëna në lidhje me njoftimet për veprat penale

Në çështjet për të cilat është ushtruar ndjekja penale gjatë vitit **2023**, janë hetuar gjithsej **915** persona, nga të cilët **605** persona të **pandehur** dhe **310** persona **nën hetim**. Ndër personat e hetuar **145** persona janë hetuar me masën e sigurimit **arrest ne burg**, kurse të tjerët janë ndjekur me masa të ndryshme sigurimi. Rezulton se në vitin 2023, **1** çështje penale kanë filluar kryesisht, janë paraqitur **45** kallëzime nga shtetasit, **58** ankime nga shtetasit, **995** referime nga policia e shtetit, **3** nga nënpunës publik, **3** nga tatimet, **1** nga policia pyjore dhe **18** referime nga policia ushtarake, **1** referime nga OSHEE, **0** nga K.L.SH, etj.

➤ *Të dhëna në lidhje me masat e sigurimit personal*

Për vitin **2023**, treguesit e arrestimeve në flagrancë dhe ndalimeve, të kryer ndaj shtetasve të dyshuar për kryerjen e veprave të ndryshme penale, paraqiten si më poshtë:

- Janë **arrestuar në flagrancë** nga policia gjyqësore **184** shtetas.
- Janë **ndaluar me iniciativë** nga policia gjyqësore **18** shtetas.
- Është nxjerrë **urdhër** ndalimi nga **prokurori** për **3** shtetas.
- Është kërkuar nga prokurori caktim mase për **38** shtetas.
- Në **1** rast është disponuar me urdhër lirimi të menjëhershëm nga ana e prokurorit, pasi ka konstatuar arrestimin ose ndalimin si të paligjshëm.

- Është kërkuar në gjykatë vlerësimi i arrestimit ne flagrancë apo ndalimit për **219** persona, ndër të cilët gjykata ka vlerësuar të ligjshëm **212** dhe të paligjshëm **7** të tillë.

Për vitin 2023, treguesit e kërkesave të prokurorit për masat kryesore të sigurimit, paraqitet si më poshte vijon :

- Nga **prokurori** është kërkuar në gjykatë për **100** persona caktimi i masës së sigurimit “**arrest në burg**”, ndërkohë që **gjykata** e ka caktuar këtë masë sigurimi ndaj **85** personave,
- Nga **prokurori** është kërkuar për **20** raste caktimi i masës së sigurimit “**arrest në shtëpi**”, ndërkohë që **gjykata** e ka caktuar këtë masë sigurimi ndaj **26** personave,
- Nga **prokurori** është kërkuar për **7** persona caktimi i masës së sigurimit “**arrest në burg me afat**”, ndërkohë që **gjykata** e ka caktuar këtë masë sigurimi ndaj **15** personave,
- Nga **prokurori** është kërkuar për **85** persona caktimi i masës së sigurimit “**detyrim për paraqitjen në policinë gjyqësore**”, ndërkohë që **gjykata** e ka caktuar këtë masë sigurimi ndaj **88** personave.

➤ *Të dhëna në lidhje me masat e sigurimit pasuror*

Gjatë vitit 2023 në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat nuk rezulton të këtë patur masa sigurimi pasuror.

➤ *Treguesit e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë*

Gjatë vitit 2023, janë nxjerrë gjithsej **880** urdhëra ekzekutimi. Nga këto **81** urdhëra janë me burgim, **320** me pezullim burgimi, **8** me gjobë, **470** urdhëra të ndryshëm kryesisht shpenzime procedurale, masa mjekësore dhe shuarje mase sigurimi.

➤ *Kriminaliteti sipas shtrirjes territoriale*

Në procedimet penale të gjykuara gjatë vitit 2023 janë gjykuar **456** shtetas, nga të cilët **451** shtetas janë mbi 18 vjeç, dhe **5** shtetas janë nën moshën 18 vjeç. Banues në qytet janë **254** shtetas, ndërsa banues në fshat janë **202** shtetas. Nga të dhënat statistikore rezulton se shtrirjen më të madhe të kriminalitetit e kanë qytetet Berat dhe Kuçovë, me rrethinat e tyre, e më pas renditen Skrapari, Ura Vajgurore e Poliçani.

➤ *Kriminaliteti sipas përhapjes së veprave penale dhe tendencave të tyre*

Lidhur me gjëndjen e kriminalitetit gjatë vitit 2023 është vënë re një ulje e lehtë e veprave penale të Kreut te Dytë të Kodit Penal, e konkretisht krime kundër personit **111** çështje me **24** persona nën hetim dhe **45** të pandehur. Nga këta **19** janë hetuar me masë sigurimi arrest në burg. Në lidhje me Kreun e Tretë te Kodit Penal, “Veprat penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike”, janë regjistruar **264** proçedime penale me **17** persona në hetim dhe **56** të pandehur. Nga këta **21** të hetuar me masën e sigurimit **arrest në burg**. Është konstatuar një numër më i ulët me vitin e kaluar, i çështjeve që kanë të bëjnë me sferën ekonomike, kryesisht veprat penale të parashikuar nga neni 170/a (rregjistruar **1** proçedime), 178 (**0** proçedim), 180 dhe 181 (rregjistruar **0** proçedime), per nenin 186/1 (**11** proçedime), 187 (**0** proçedim), 189 (**0** proçedime), 190/1 (**1**

proçedime), 191 (0 proçedim), 197 dhe 198 (13 proçedime), 248 (11 proçedime) dhe 259 (0 proçedim).

➤ *Kriminaliteti sipas strukturës së Kodit Penal (krime-kundërvajtje)*

Bazuar në ndarjen e veprave penale sipas kategorizimit të tyre në krime dhe kundërvajtje penale, vlerësoj se krimet paraqesin tendencën më të lartë në vitin 2023 në qarkun e Beratit. Përgjatë vitit 2023 është hetuar për rreth 172 kundërvajtje penale dhe 596 krime.

